



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS

TEATRI KOMBËTAR I OPERAS, BALETIT DHE ANSAMBLIT POPULLOR

Nr. ____ Prot

Datë ____ / ____ / 2022

NJOFTIM

Teatri Kombëtar i Operas, Baletit dhe Ansamblit Popullor, në mbështetje të Statutit të Institucionit të TKOBAP miratuar me urdhër të Ministrit të Ministrisë së Kulturës nr 166 datë 27.04.2015; Rregullores së Brendshme të Institucionit; Organikës dhe Strukturës së Institucionit miratuar me Urdhër të Kryeministrit nr 140, datë 28.03.2014 shpall 1 vend vakant për pozicionin e punës: **Drejtor/e pranë Drejtorisë së Produksionit Skenik**.

Kandidatët për pozicionin e punës duhet të plotësojnë kërkesat si më poshtë:

➤ **Drejtor/e pranë Drejtorisë së Produksionit Skenik**

Kërkesat e përgjithshme që duhet të plotësojnë personat që aplikojnë:

1. Të jetë shtetas shqiptar;
2. Të zotërojë gjuhën shqipe të shkruar dhe të folur;
3. Të jetë në kushte shëndetësore që e lejon të kryejë detyrën përkatëse;
4. Të përmbushë kërkesat ligjore për nivelin arsimor dhe të zotërojë aftësitë e nevojshme profesionale për vendin përkatës të punës;
5. Të mos jetë dënuar me vendim të formës së prerë të gjykatës për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundravajtje penale me dashje;
6. Ndaj tij të mos jetë marrë masë disiplinore e largimit nga puna për shkak të një shkeljeje të rëndë disiplinore;

Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e posaçme sa vijon:

1. Të ketë përfunduar studimet e larta bachelor + mastër në Art Figurativ ose diplomën ekuivalente me to);
2. Të ketë përvojë pune jo më pak se tre vjet;
3. Të njohë dhe të përdorë programet kompjuterike;
4. Të ketë aftësi të mira komunikimi - ndërpersonale, të shkruara dhe verbal;
5. Të ketë aftësi të organizojë punën duke përmbushur afatet;
6. Të ketë aftësi të administrojë dhe kontrollojë veprimtarinë prodhuese për përcaktimin e saktë të sasisë së materialeve dhe zbatimin teknik të procesit në prodhim deri në daljen e produktit të gatshëm.
7. Të ketë aftësi të monitorojë në vijim punën në lidhje me zbatimin e kontratave të lidhura, realizimin e shërbimeve dhe furnizimin e institucionit me bazë materiale.

8. Të ketë aftësi të organizojë dhe të ndjekë zhvillimin e punës të stafeve në varësi të tij në bazë të platformës së drejtorit të përgjithshëm.
9. Të ketë njohuri të mira të gjuhës angleze.
10. Të njohë dhe të zbatojë rregullat e etikës në administratën publike;

Përgjegjësitë/Detyrat Kryesore;

1. Përgjegjësinë për përcaktimin e objektivave dhe planifikimin e veprimtarisë së drejtorisë së produksionit duke organizuar dhe koordinuar proceset e punës dhe shfaqjeve. Përgjegjësinë për produksionet e operave, baletit dhe shfaqjeve të ndryshme që ngjiten në skenën e TKOBAP-së.
2. Përgjegjësinë për drejtimin dhe organizimin e punës në Drejtorinë e Produksionit Skenik për prodhimin e dekoreve, kostumeve, rekuizitës etj të të gjitha shfaqjeve duke angazhuar stafin e punonjësve duke bashkërenduar punën me strukturat e tjera financiare - administrative.
3. Përgjegjësinë për dhënien e ndihmës në përgatitjen/hartimin e planit financiar të shfaqjeve sipas kalendarit artistik të TKOBAP-së.
4. Përgjegjësinë në bashkëpunim me zyrën e burimeve njerzore për të ndjekur disiplinën në punë, si dhe shfrytëzimin e drejtë të kohës së punës, për realizimin sa më cilësor të kalendarit artistik.
5. Përgjegjësinë për ndjekjen e proceseve të punës të produksioneve të shfaqjeve që ngjiten në skenën e TKOBAP-së dhe jo vetëm, gjatë sezonit artistik në të gjitha fazat duke organizuar takime me ekipet e autorëve dhe përgjegjësit e sektorëve të teknikës së TKOBAP-së.
6. Përgjegjësinë mbi hartimin, ideimin dhe skedimin e materialeve që duhen për realizimin e dekoreve dhe kostumeve në bashkëpunim me skenografin dhe kostumografin e shfaqjeve.
7. Përgjegjësinë mbi planifikimin në raport me shfaqjet e kalendarit artistik kontratat me te tretët për përmbushjen në kohë dhe me cilësi të detyrave në zbatim të objektivave të Drejtorisë dhe porosive të titullarit të Institucionit apo të Ministrisë.
8. Përgjegjësinë mbi planifikimin në bashkëpunim me përgjegjësit e teknikës ndricimin dhe foninë në raport me shfaqjet e kalendarit artistik
9. Përgjegjësinë mbi planifikimin, montimin dhe provat në skenë sipas kërkesave të regjisë. Drejtorit të Produksionit Skenik i kërkohet që të zgjidhe probleme profesionale që kanë rëndësi për institucionin; kordinon drejtpërdrejtë dhe ndjek zbatimin e aktiviteteve artistike.
10. Përgjegjësinë për raportimin tek Drejtori i Përgjithshëm lidhur me rezultatet e punës si dhe problematikat e hasura.
11. Përgjegjësinë për planifikimin dhe drejtimin me aprovimin e Drejtorit të Përgjithshëm procesin për vendet vakante të punës brenda Drejtorisë së tij.
12. Përgjegjësinë për udhëzimin e stafit për përmbushjen e aktivitetit të përditshëm të drejtorisë dhe siguron që kjo veprimtari të jetë në përputhje me politikat institucionale dhe standartet përkatëse.
13. Përgjegjësinë për identifikimin e nevojave për zhvillimin e politikave të Drejtorisë së Produksionit Skenik dhe bën rekomandime brenda funksionit të tij, për përmirësimin e mëtejshëm të saj.

Dokumentacioni, mënyra dhe afati i dorëzimit

1. Jetëshkrimi CV;
2. Fotokopje të diplomës dhe të listës së notave të noterizuara.
3. Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
4. Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
5. Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
6. Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore;
7. Çdo dokument tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive, rekomandime apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin e kandidatit.

Dokumentacioni do të dorëzohet pranë sekretarisë së TKOBAP(zyra e protokollit) ose të skanuara në mailin zyrtar të TKOBAP-së sekretaria@tkob.gov.al deri me datë 03/10/2022. Pas verifikimit të dokumentave të kërkuara, në Teatrin Kombëtar të Operas Baletit dhe Ansambllit Popullor, kandidatët të cilët plotësojnë kriteret e kërkuara do të lajmërohen nepërmjet numrit të tyre të kontaktit ose mail nga Sekretaria e Institucionit, për intervistën e strukturuar me gojë.

Të gjitha njoftimet për shpalljet e vendeve të lira, si dhe data kur do të shpallet fituesi, mund ti gjeni në faqen zyrtare të web-it të Teatrit Kombëtar të Operas Baletit dhe Ansambllit Popullor www.tkob.gov.al; faqja zyrtare e Agjensisë së Prokurimit Publik www.app.gov.al.

DREJTORE e PËRGJITHSHME

Abigeila VOSHTINA